



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E SEKRETARIT DHE TË ANËTARIT TË KZAZ Nr. 41, SHKARKIM DHE EMËRIM KRYESISHT TË ANËTARIT TË KZAZ NR. 23, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 23.04.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Lirim dhe emërimin e sekretarit dhe të anëtarit të KZAZ nr. 41, shkarkim dhe emërim kryesisht të anëtarit të KZAZ nr. 23, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 21, pika 11, neni 29, pika 5, neni 32, pika 1 gërma "c", pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Partia Socialiste e Shqipërisë me shkresën nr.2378 prot., datë 16.04.2019, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, ka kërkuar lirim dhe emërim të sekretarit të KZAZ nr. 41, Qarku Tiranë, lirim dhe emërim të anëtarit të KZAZ nr.41, Qarku Tiranë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë për propozimet për anëtarin dhe sekretarin e KZAZ-së nr.41, i gjen ato në përputhje me kërkesat e nenit 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor.



Nr. 183 i Vendimit Data 23.04.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për lirim dhe emërimin e sekretarit dhe të anëtarit të KZAZ nr. 41, shkarkim dhe emërim kryesisht të anëtarit të KZAZ nr. 23, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 141, datë 09.04.2019, plotësoi vakancën në KZAZ-në nr. 23, duke emëruar kryesisht në pozicionin e anëtarit shtetasin Alisi Bena. Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor nr. 23, me shkresën nr.2398 prot., datë 17.04.2019, njofton KQZ se anëtari i emëruar kryesisht nuk është paraqitur në detyrë dhe nuk ka marrë pjesë në mënyrë të vijueshme në mbledhjet e KZAZ-së. KQZ, në zbatim të nenit 32, pika 1, germa "c", të Kodit Zgjedhor, shkarkon nga detyra anëtarin e emëruar kryesisht.

KQZ konstaton vakancën në KZAZ nr. 23, dhe plotëson duke emëruar kryesisht shtetasit nga lista e miratuar me vendimin nr. 141, datë 09.04.2019, dhe me vendimin nr. 173, datë 16.04.2019. Pas emërimeve kryesisht nga KQZ për plotësim të vakancave të KZAZ-ve të Bashkisë Durrës, rezulton se në listën e shtetasve me vendbanim në zonën zgjedhore Bashkia Durrës, figurojnë të pa emëruar kryesisht nga KQZ: Elga Nikolla Gogo dhe Mexhit Riza Allaraj. KQZ plotësoi vakancën duke përzgjedhur sipas procedurës së përcaktuar në nenin 2/1 të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 21, pika 11, nenin 29, pika 5, nenin 32, pika 1 germa "c", pika 2 germa "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra sekretarin dhe anëtarin e KZAZ nr. 41, sipas kërkesës së subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas lidhjes nr.1.
2. Të emërojë sekretarin dhe anëtarin e KZAZ nr. 41, të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas lidhjes nr.2.
3. Të shkarkojë anëtarin e emëruar kryesisht të KZAZ nr. 23, sipas lidhjes nr. 1.
4. Të emërojë kryesisht anëtarin e KZAZ nr. 23, sipas lidhjes nr. 2.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar



Nr. 183 i Vendimit Data 23.04.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për lirimin dhe emërimin e sekretarit dhe të anëtarit të KZAZ nr. 41, shkarkim dhe emërim kryesisht të anëtarit të KZAZ nr. 23, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

Edlira

JORGAQI-

Anëtare

Rezarta

BITRI

Anëtare



Nr. 183 i Vendimit Data 23.04.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për lirim dhe emërimin e sekretarit dhe të anëtarit të KZAZ nr. 41, shkarkim dhe emërim kryesisht të anëtarit të KZAZ nr. 23, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.